



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 15-86/2021 regjistër (JR)
Datë 10.06.2025

Nr. 56/1 vendimit
Datë 19.06.2025

VENDIM
PËR NDREQJE GABIMI

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 19.06.2025, ditën e enjte, në orën 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, kërkesën për korrigjimin e gabimit material në vendimin nr. 56 (JR), datë 12.11.2024, me:

KËRKUESE:

Saemira Hila

OBJEKTI:

Ndreqja e gabimit material në vendimin nr. 56 (JR), datë 12.11.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Saemira Hila.

BAZA LIGJORE:

Neni 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”); neni 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”); neni 312 i Kodit të Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi në dhomë këshillimi, kërkesën e znj. Saemira Hila, për ndreqjen e gabimit material në vendimin nr. 56 (JR), datë 12.11.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket këtij subjekti rivlerësimi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN NË MËNYRË TË PËRMBLEDHUR:

1. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me vendimin nr. 56 (JR), datë 12.11.2024, ka lënë në fuqi vendimin nr. 473, datë 05.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Saemira Hila. Në datën 10.06.2025, vendimi i sipërcituar i është komunikuar subjektit të rivlerësimit dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, nëpërmjet postës elektronike.
2. Pas komunikimit të këtij vendimi, subjektit të rivlerësimit, znj. Saemira Hila, ka konstatuar një gabim në shkrim të bërë në vendim dhe, me anë të postës elektronike, më datë 10.06.2025, ka kërkuar që, bazuar në nenin 312 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues të ndreqë gabimin e konstatuar prej saj. Znj. Saemira Hila, në kërkesën e saj, ka evidentuar se nga një lexim i vendimit ka konstatuar se në faqen 2, paragrafi 2.1 të tij, është referuar një konkluzion i cili nuk gjen pasqyrim në raportin e ILDKPKI-së të përcjellë për të në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, konkretisht konkluzioni se “ka kryer fshehje të pasurisë”. Më tej, ka referuar se ky konkluzion nuk gjen pasqyrim në paragrafin 10, faqe 3 të vendimit të Komisionit, në të cilin janë referuar konkluzionet/konstatimet e raportit të ILDKPKI-së.
3. Trupi gjykues, pasi u njoh me këtë gabim në shkrim, vlerëson se situata është pikërisht ajo që rregullohet nga neni 312 i Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: *“Pas shpalljes së vendimit, gjykata nuk mund ta anulojë ose ta ndryshojë atë. Ajo me kërkesën e palëve ose kryesisht mund të ndreqë në çdo kohë vetëm gabimet e bëra në shkrim ose në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të vendimit. [...]”*, që legjitimon gjykatën të ndreqë gabimet me kërkesë të palëve. Kolegji vlerëson se zbatimin e nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile e dikton parashikimi i nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe neni 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, dispozita të cilat orientojnë Kolegjin në aplikimin e normave të Kodit të Procedurës Civile, në rast se situatat ligjore të prezantuara për zgjidhje nuk gjejnë një zgjidhje të posaçme nga vetë ligji nr. 84/2016. Në këto kushte, Kolegji vlerësoi se me anë të ndreqjes së këtyre gabimeve nuk ndryshohet vullneti i Kolegjit, i formuar me rastin e dhënies së vendimit që konkretizohet me shpalljen e tij, dhe as nuk preket përmbajtja e dispozitivit të vendimit nr. 56 (JR), datë 12.11.2024.

4. Trupi gjykues, në përfundim, çmoi se duhet të procedohet me korrigjimin e gabimit në shkrim, duke vendosur në paragrafin 2.1 të vendimit nr. 56 (JR), datë 12.11.2024, fjalën “nuk” para togut të fjalëve “ka kryer fshehje pasurie”.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në zbatim nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Ndrejken e gabimit në shkrim në vendimin nr. 56 (JR), datë 12.11.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në paragrafin 2, nënparagrafi 2.1, para togut të fjalëve “ka kryer fshehje pasurie”, shtohet fjala “nuk”.
2. Ky vendim i bashkohet vendimit nr. 56 (JR), datë 12.11.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe është pjesë përbërëse e tij.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 19.06.2025.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi